



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 100 prot.

Tiranë, më 13. 01. 2022

V E N D I M

Nr. 16, datë 13. 01. 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 241, datë 29.12.2021, të shtetasve Z. Ll., Z. L., F. J., Gj. L. dhe M. L., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”¹, nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Vau i Dejës.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjektet ankues, pretendojnë se kanë qenë punonjës të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Vau i Dejës. Pas zgjedhjeve vendore të zhvilluara më datë 30.06.2019, në pozicionin e Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës është emëruar M. B., propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Sapo M. B., ka nisur ushtrimin e detyrës, ankuesit pretendojnë se kanë nisur procedurat e largimit nga puna të punonjësve, anëtarë të Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Referuar pretendimeve në ankesë, largimet e tyre nga puna, kanë ardhur menjëherë pas zëvendësimit të Administratorit të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Vau i Dejës. Sipas tyre, në momentin e emërimit të M. B., është larguar nga detyra Administratorja e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Vau i Dejës dhe është zëvendësuar me I. B., i cili është përfaqësues politik i Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Përsa më sipër, ankuesit pretendojnë se zgjidhja e marrëdhënieve të tyre të punës, është një veprim i cili lidhet me bindjet e kundërta politike me Kryetarin e Bashkisë Vau i Dejës. Në këtë

¹ Referuar dokumentave të anëtarësisë subjektet ankues rezultojnë të jenë anëtarë të subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë.

kuptim, kërkojnë nga Komisioneri, të konstatojë situatën diskriminuese për shkak të bindjeve politike dhe rikthimin e tyre në pozicionet e mëparshme të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7/1 i LMD-së², parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”*.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në vijim, ankuesit me e-mail-it datë 10.01.2022, të dërguar në adresë të inspektorit të çështjes, kanë kërkuar të tërheqin ankesën, pasi do ta paraqesin atë duke kërkuar secili prej tyre shqyrtimin e çështjeve të ndara dhe jo në grup personash.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”* parashikohet se: *“Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e*

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Tërheqja e kërkesës.....: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga shtetasit Z. Ll., Z. L., F. J., Gj. L. dhe M. L., të cilët me anë të kërkesës me e-mail, datë 10.01.2022 janë tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesit janë tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 241, datë 29.12.2021, paraqitur nga shtetasit Z. Ll., Z. L., F. J., Gj. L. dhe M. L. kundër Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime sh.a., Vau i Dejës, për shkak se ankuesit janë tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindje politike)

(Fusha: Punësim)